



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 195, Datë 13.07.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E SHOQËRISË
“IDI 2005” SH.P.K. PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN
(NËPËRMJET BARRËSIMIT) E ASETVE FIKSE TË SAJ SI MJET PËR
GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SH.A.**

Në mbështetje të neneve 16, 20, gërma “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, gërma “b”, nenit 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të asetve nga të licensuarit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.07.2016; nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1959/1 prot., datë 10.07.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për barrësimin e asetve fikse të saj, në favor të “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.”,

Konstatohet se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për Marrjen e Autorizimit

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 30, datë 27.03.2024, nga HEC Arcovë me kapacitet të instaluar 1.28 MW, me vendndodhje Përroi i Arçovës, degë e përroit të Selcës dhe Holtës me derdhje në lumin Shkumbin, Qarku Elbasan.
- Me shkresën nr. 1959 prot., datë 25.06.2026 shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e asetve të HEC Arcovë, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a..

2. Shqyrtimi i Kërkesës dhe Dokumentacionit të Paraqitur

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe të neneve 2, gërma “a”, 3, 5, gërma “j” dhe 6 të Rregullores së procedurave të transferimit të asetve nga të licensuarit, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, rezulton se ERE miraton kërkesat e të licensuarave për transferimin e asetve fikse (të paluajtshme) që i shërbejnë veprimtarisë së licensuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në mbështetje të përcaktimeve të nenit 7 të *Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit*, rezulton se nevojitet të plotësohet dhe dokumentacioni në vijim:

Neni 7, Pika 1

- **gërma “a”** Shoqëria duhet të përcjellë në ERE ekstraktin historik të shoqërisë tregtare.
- **gërma “c”** Shoqëria duhet të bëjë me dije në lidhje me gjendjen financiare aktuale të saj dhe efektin që parashikon pas miratimit të transferimit të aseteve.
- **gërma “d”** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion në lidhje me kandidatin e propozuar për transferimin e aseteve (Intesa SanPaolo Bank Albania sh.a.).
- **gërma “h”** Shoqëria duhet të depozitojë Kontratën e Hipotekës dhe/ose Marrëveshjen Siguruese, së bashku me listën e detajuar të aseteve dhe vlerat përkatëse. Po ashtu, vlerësohet t'i kërkohej shoqërisë të bëjë me dije lidhur me statusin e zbatimit/disbursimit të kësaj kontrate.
- **gërma “i”** Shoqëria duhet të paraqesë në ERE deklaratën e bankës, ku të shprehet gatishmëria e saj që të garantojë vetë/me palë të tjera veprimtarinë e licencuar në rast të transferimit të aseteve.
- **gërma “j”** Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka listë transferimesh të kryera me herët prej saj.
- **Pika 3** Shoqëria duhet të bëjë me dije në rast se i është drejtuar MIE-s në lidhje me këtë procedurë.
- **Pika 6** Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të përcjellë që kërkon të mos jetë e hapur për publikun.

Nga analiza paraprake nuk rezultojnë rrethana që të pengojnë fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës, ndërsa vlerësimi mbi përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore dhe rregullatore do të kryhet në përfundim të procedurës administrative, pas administrimit të dokumentacionit të plotë dhe analizës nga ERE.

Për sa më sipër, vlerësohet se janë plotësuar kushtet procedurale për fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a. .

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a. (referuar kontratës së kredisë nr. 4995 rep, nr. 3372 kol, datë 30.08.2025).
2. Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. , të depozitojë në ERE dokumentacionin dhe sqarimet shtesë të kërkuara gjatë shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë “IDI 2005” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI